

20151935327

L I G J PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË LIGJIT PËR MBIKEQYRJE INSPEKTUESE

Neni 1

Në Ligjin për mbikëqyrje inspektuese ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " numër 50/10, 162/10, 157/11, 147/13, 41/14 dhe 33/15), në nenin 19 pas paragrafit (10) shtohen tre paragrafi të rinj (11), (12) dhe (13), si vijojnë:

"(11) Këshilli inspektues do të përcaktojë person përgjegjës nga radhët e të punësuarve në këshill e cila do të kryejë kontroll nëse kandidatët e lajmëruar për dhënien e provimit i plotësojnë kushtet nga paragrafi (2) të këtij neni.

(12) Nëse kandidati nuk i plotëson kushtet nga paragrafi (2) të këtij neni, personi përgjegjës do sjellë vendim me të cilën refuzohet kërkesa për dhënien e provimit, kundër të cilës kandidati i pakënaqur mund të ngrit kontest administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit.

(13) Personit përgjegjës nga paragrafi (11) të këtij neni për çdo sesion të provimit të mbajtur i takon kompensim me para, në shumë prej një të tretës nga rroga neto mesatare në Republikën e Maqedonisë, për çka Këshilli Inspektues miraton aktvendim."

Paragrafët (11), (12) dhe (13) bëhen paragrafë (14), (15) dhe (16).

Neni 2

Në nenin 19-v paragrafin (6) shtohen katër paragrafë të rinj (7), (8), (9) dhe (10) si vijon:

"(7) Personi juridik i autorizuar që teknikisht e zbaton provimin obligohet ta bllokojë shtrirjen e radiofrekuencës në hapësirat për dhënien provimit për kohën e zbatimit të provimit.

(8) Agjencia për Komunikime Elektronike (në tekstin e mëposhtëm: AKE) kryen monitorim të përhershëm të bllokimit të shtrirjes së radiofrekuencës në hapësira për dhënien e provimit, me qëllim të pengohet çdo lloj të komunikimit elektronik me rrethin jashtë nga hapësira për dhënien e provimit.

(9) AKE në hapësirën për dhënien e provimit instalon pajisje matëse e cila siguron regjistrim elektronik nga matjet e kryera në kohëzgjatje prej 30 ditëve, dhe e njëjta magazinohet në sistemin kontrollues qendror të AKE.

(10) AKE formon komision treanëtarësh e cila përgatit raport në bazë të regjistrimeve elektronike të magazinuar në sistemin kontrollues qendror të AKE dhe e njëjta dorëzohet deri te Komisioni më së voni në afat prej 15 ditëve nga mbarimi i provimit."

Paragrafët (7), (8), (9), (10) dhe (11) bëhen paragrafë dhe (11), (12), (13), (14) dhe (15).

Paragrafi (12) i cili bëhet paragrafi (16) ndryshohet si vijon:

"Kandidatit i cili gjatë dhënies së provimit vepron në kundërshtim me paragrafët (11) (12) dhe (13) të këtij neni nuk do t'i lejohet dhënia e më tejshme e provimit dhe i vendoset i një ndalesë për dhënien e provimit për inspektori në afat prej tre vitesh, për çka kryetari i Këshillit të Inspektues miraton vendim kundër të cilit ju mund të ngritë kontest administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit."

Neni 3

Në nenin 19-g paragrafi (5) ndryshohet dhe vijon:

"Këshilli Inspektues dy herë në vit kryen ndërrim të më së paku 30% të pyetjeve dhe të studimeve në rast nga bazat me pyetje të reja dhe studime të rastit."

Pas paragrafit (6) shtohen dy paragrafë të rinj (7) dhe (8) si vijojnë:

"(7) Komisioni nga paragrafi (2) të këtij neni mblidhet më së voni 15 ditë pas çdo provimi të mbajtur dhe kryen revizion të zbatimit të provimit, duke përfshirë edhe nëse provimin e kanë kaluar kandidat të cilët i plotësojnë kushtet për dhënien e provimit në pajtim me nenin 19 paragrafi (11) të këtij ligji, për çka dorëzon raport te kryetari i Këshillit Inspektues.

(8) Anëtarëve të Komisionit për revizion në nivel vjetor u takon kompensim me para, në shumë prej një të tretës nga rroga neto mesatare në Republikën e Maqedonisë, për çka Këshilli Inspektues miraton aktvendim.”

Neni 4

Në nenin 19-d pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5), si vijon:

"(5) Kandidatët të cilëve u është lejuar kërkesa për dhënien e provimit dhe publiku informohen për datën dhe kohën e dhënies së provimit, më së paku tetë ditë para mbajtjes së provimit përmes ueb faqes të Këshillit Inspektues dhe Servisi Publik Radiodifuziv."

Neni 5

Në nenin 63 paragrafi (1) në fjalinë hyrëse fjalët: "2.000 deri " shlyhen.

Paragrafi (2) ndryshohet dhe vijon:

"(2) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni ."

Në paragrafin (3) fjalët: "1.000 deri 1.500 euro" zëvendësohen me fjalët: "300 deri 450 euro".

Neni 6

Në nenin 63-a në paragrafin (1) fjalët: " 1.500 deri 3.000" zëvendësohen me fjalët: "1.000 deri 2.000", në alinenë 2 lidhëza "dhe" zëvendësohet me presje, në alinenë 3 pika zëvendësohet me lidhëzën " dhe" dhe shtohet aline e re 4 si vijon:

"- nuk miraton aktvendim me të cilin kandidatit i shqiptohet ndalesë për dhënien e provimit të inspektorit administrativ në kohëzgjatje prej tre viteve, në pajtim me nenin 19-v paragrafi (16) të këtij ligji."

Në paragrafin (2) fjalët: "7.500 deri 15.000" zëvendësohen me fjalët: "2.000 deri 4.000" .

Në paragrafin (3) fjalët: "1.500 deri 3.000" zëvendësohen me fjalët: "1.000 deri 2.000" .

Neni 7

Në nenin 63-b në fjalinë hyrëse fjalët: "7.500 deri 15.000" zëvendësohen me fjalët: "2.000 deri 4.000 euro".

Neni 8

Pas neni 63-b shtihet nen i ri 63-v, si vijon:

"Neni 63-v

"(1) Me gjobë prej 2.000 deri 3.000 në kundërvlerë me denarë do të dënohet personi përgjegjës nga neni 19 paragrafi (11) të këtij ligji, nëse nuk sjell vendim për refuzimin e kërkesës për dhënin e provimit të kandidatit i cili nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 19 paragrafi (12) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 10.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personin juridik të autorizuar i cili e zbaton provimin nëse nuk e bllokoi shtrirjen e radiofrekuencës në hapësirat për dhënien e provimit në pajtim me nenin 19-v paragrafi (7) të këtij ligji.

(3) Gjobë në shumë prej 100 deri 200 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet kandidatit i cili gjatë kohës së dhënies së provimit shfrytëzon ligje, ligje me komente dhe sqarime, telefona mobil, pajisje kompjuterike portative dhe pajisje tjera teknike dhe informatike, lëndë të përgatitura paraprake dhe ngjashëm në pajtim me nenin 19-v paragrafi (8) të këtij ligji.

(4) Gjobë në shumë prej 2.000 deri 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet anëtarëve të Komisionit nëse në afat prej 15 ditësh pas çdo provimi të mbajtur për inspektor nuk kryejnë revizion të zbatimit të provimit, ose nuk dorëzon raport deri te Këshilli Inspektues në pajtim me nenin 19-g paragrafi (7) të këtij ligji."

Neni 9

Neni 64 ndryshohet dhe vijon:

"(1) Për kundërvajtje nga neni 63, 63-a dhe 63-b nga ky ligj, inspektori kompetent është i obliguar kryerësit të kundërvajtjes t'i lëshojë urdhër pagesë kundërvajtëse në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

(2) Inspektori kompetent është i obliguar të mbajnë evidencë për urdhër pagesat e lëshuara kundërvajtëse dhe për epilogun e procedurave të ngritura.

(3) Në evidencën nga paragrafi (2) të këtij neni mblidhen, përpunohet dhe ruhen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri, respektivisht emërtimi i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, respektivisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhër pagesës kundërvajtëse e cila i lëshohet dhe rezultati i procedurës.

(4) Të dhënat personale nga paragrafi (3) të këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencë.

(5) Formën dhe përmbajtjen e urdhër pagesës kundërvajtëse e përcakton ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës."

Neni 10

Pas nenit 64 shtohen dy nene të reja 64-a dhe 64-b, si vijojnë:

"Neni 64-a

Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligji, procedura kundërvajtëse mban edhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.

Neni 64-b

Matja e shumës së gjobës për personin juridik kryhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje."

Neni 11

Akti nënligjor i paraparë me këtë ligj do të miratohet në afat prej 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare në Republikën e Maqedonisë".